

Komentari i Buxhetit 2024 për Shqipërinë nën këndvështrimin gjinor

1. Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim (GADC) është një organizatë shqiptare jofitimprurëse që vepron në të gjithë Shqipërinë. GADC është një zë dhe forcë për ndryshim për gratë shqiptare. Organizata jonë punon në të gjithë Shqipërinë për të fuqizuar gratë dhe për të krijuar një të ardhme të barabartë dhe të drejtë për vajzat dhe gratë me të ardhura të ulëta që të dalin nga varfëria dhe përjashtimi.

2. **Shqipëria është shndërruar nga një nga vendet më të varfra në Evropë në një vend me të ardhura të mesme.** Vendi po zbaton reforma të rëndësishme për të rigjallëruar rritjen ekonomike dhe krijimin e vendeve të punës, duke avancuar njëkohësisht axhendën e integritimit në Bashkimin Evropian.

3. **Buxheti i Shtetit për vitin 2024 është miratuar më 7 dhjetor 2023 në bazë të ligjit nr. 97/2023,** për Buxhetin e Vitit 2024 nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë. Buxheti për qytetarët përgatitet çdo vit nga Ministria e Financave. Sipas Buxhetit për Qytetarët (BpQ), gjatë vitit 2024 janë planifikuar 674.7 miliardë lekë, me një rritje prej 4.1% krahasuar me vitin 2023. Rreth 9.3% e shpenzimeve të përgjithshme publike do t'i dedikohen politikave publike me bazë gjinore, të cilat synojnë zvogëlimin e hendeqeve. Kjo pjesë e buxhetit ka si qëllim të mbështesë vajzat dhe gratë dhe të zvogëlojë boshllëqet gjinore në të gjitha fushat e jetës, në mënyrë që askush të mos mbetet pas.

4. Në buxhetin e shtetit shqiptar të vitit 2024, **rreth 9.3% e shpenzimeve të përgjithshme publike do t'i dedikohen politikave publike me bazë gjinore,** të cilat synojnë zvogëlimin e hendeqeve gjinore në fusha të ndryshme.

5. **Zbatimi i buxhetimit të përgjigjshëm gjinor ka vazhduar të përmirësohet në Shqipëri.** Vit pas vitit duke e shtuar qeveria shqiptare ka zbatuar një sërë masash që synojnë mbështetjen e familjeve, grave dhe vajzave, dhe grupeve të cënueshme

6. **Ndihma ekonomike për viktimat e dhunës në familje** është rritur ndjeshëm.

7. Sidoqoftë zbatimi i ligjit mbi barazinë gjinore, përditësimi i tij duhet të jetë prioritet i qeverisë Shqiptare.

8. Gjithashtu në buxhetin e vitit 2024, nuk ka të specifikuar nëse mungesat buxhetore në planin e veprimit të strategjisë kombëtare për barazinë gjinore janë plotësuar apo do të plotësohen.

9. Në faqen zyrtare të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë **nuk ka dokumenta të përditësuar për buxhetimin gjinor.** Dokumentat datojnë që prej vitit 2021.

10. Z. Ervin Mete, Ministri aktual i Financave (deri në fund të dhjetorit 2023 edhe i Ekonomisë), ende nuk ka dhënë ndonjë deklaratë zyrtare që trajton fokusin e Ministrisë mbi çështje kritike si ndjeshmëria gjinore, popullatat e cënueshme, apo tema më të gjera të përfshirjes sociale. Mungesa e tillë e angazhimit është shqetësuese pasi sugjeron një hap prapa në diskursin zyrtar në lidhje me çështjet e barazisë gjinore, krahasuar **me përfshirjen e ministreve të mëparshme gra, të cilat shpesh kanë folur shpesh për çështjet e lartpërmendura.**

11. **Shpenzimet e buxhetit vendor për vitin 2024 janë parashikuar në masën 71.1 miliardë lekë, me një rritje prej 10.4% në raport me buxhetin e vitit 2023.** Këto shpenzime do të zënë 2.9% të Prodhimit të Brendshëm Bruto (PBB). Sidoqoftë nuk ka asnjë analizë gjinore që të tregojë se si ky buxhet ndikon në jetën e grupeve të marginalizuara ku gratë zënë një vend të konsiderueshëm.

12. Buxheti 2024 për skemën e pensioneve do të financojë rreth 185.8 miliardë lekë, duke siguruar fondet e nevojshme për indeksimin e pensioneve si dhe bonusin e përvitshëm për pensionistët, **por nuk ka asnjë informacion në lidhje me personat e moshës së tretë** që jetojnë në varfëri dhe që marrin pension “sa për të mbajtur frymën gjallë”.

13. Sektori i arsimit do të financohet në total me 78.8 miliardë lekë ose 3.2% e PBB-së, sidoqoftë **nuk ka një analizë gjinore në lidhje me shumë problematika që lidhen me investimet në sektorin** e arsimit ku shumica e mësimdhënësve janë gra e vajza dhe ku nxënëset/studentet kanë mangësi të shumta që lidhen me shëndetin dhe higjienën si dhe aspekte të tjera të rëndësishme si për vajzat ashtu edhe për djemtë. Investimi i parashikuar në sektorin e arsimit është një angazhim domethënës që tregon prioritetin e qeverisë për arsimin. Ky nivel investimi është thelbësor për adresimin e nevojave të ndryshme brenda sektorit, si përmirësimet e infrastrukturës, përmirësimet e teknologjisë, pagat e mësuesve dhe burimet e studentëve, të cilat janë thelbësore për rritjen e cilësisë së arsimit. Megjithatë, nuk ka analiza gjinore lidhur me këtë investim ç’ka ngre shqetësime për detaje të rëndësishme. Analiza gjinore gjithëpërfshirëse është jetike për disa arsye: Së pari, siguron që fondet të ndahen në mënyrë efikase dhe efektive, duke synuar fushat e sektorit të arsimit që kanë më shumë nevojë për to. Pa analiza të detajuara, ekziston rreziku i shpërndarjes së padrejtë të burimeve, gjë që mund të çojë në joefikasitet ose neglizhencë të fushave kritike që kanë nevojë për mbështetje. Së dyti, analiza ndihmon në përcaktimin e objektivave të qarta dhe matjen e rezultateve, duke u mundësuar palëve të interesuara të vlerësojnë ndikimin e investimit në cilësinë e arsimit, aksesueshmërinë dhe barazinë. Së fundi, siguron transparencë dhe llogaridhënie, duke i lejuar publikut dhe palëve të tjera të interesuara të kuptojnë se si dhe pse merren vendimet dhe cilat përfitime priten.

14. **Sektori i Shëndetësisë do të financohet me rreth 72.2 miliardë lekë në vitin 2024 ose 3% e Produktit të Brendshëm Bruto.** Një analizë gjithëpërfshirëse e buxhetit të shtetit e fokusuar në çështjet gjinore brenda sektorit të shëndetësisë është thelbësore për promovimin e barazisë gjinore në shëndetësi.

Duke siguruar që alokimet buxhetore reflektojnë nevojat e ndryshme të popullsisë, qeveria shqiptare mund të bëjë përparim të rëndësishëm drejt përmirësimit të rezultateve shëndetësore për të gjitha gjinitë, duke kontribuar kështu në mirëqenien dhe zhvillimin e përgjithshëm të shoqërisë. Analizimi i çështjeve gjinore brenda sektorit të shëndetësisë në lidhje me alokimet e buxhetit të shtetit përfshin shqyrtimin se si vendimet buxhetore ndikojnë në mënyra të ndryshme tek burrat dhe gratë dhe duke siguruar akses të barabartë në shërbimet shëndetësore për të gjitha gjinitë. Kjo analizë është thelbësore për identifikimin dhe adresimin e pabarazive në rezultatet shëndetësore, disponueshmërinë e shërbimeve dhe cilësinë e kujdesit.

15. Buxheti 2024 mbështet më tej reformën në drejtësi, duke alokuar 26.8 miliardë lekë për këtë sektor, 4.8 miliardë lekë më shumë krahasuar me buxhetin e vitit 2023.

16. **Artizanati është një sektor që po lulëzon në Shqipëri** dhe analiza gjinore e realizuar nga GADC ofron një udhërrëfyes konkret për mbështetjen e tyre në nivel qendror dhe lokal. Në buxhetin e shtetit shqiptar 2024 përmendet që do të ndihmohen gratë artiste dhe artizane, sidoqoftë aty nuk ka asnjë shifër, **indikator apo % të dedikuar këtyre grave**. Pa këto është e pamundur të matet realizimi.

17. **Buxheti i shtetit 2024 është i qartë në disa fusha prioritare**, ku përcaktohet qartë ndihma direkte për gratë dhe vajzat si në shembujt mëposhtme:

a 500 gra e vajza do të përfitojnë shërbime të targetuara **informacioni dhe këshillimi bujqësor** me një fond prej 2,300,000 lekësh, duke rritur numrin e grave që përfitojnë shërbimet e këshillimit dhe informacionit bujqësor.

b. Politikat shëndetësore do të vijojnë të mbështesin nënat e reja me shërbime të shëndetit parësor dhe dytësor, ku rëndësi të veçantë zënë investimet në maternitetet e reja me rreth 39.5 milionë lekë.

c. **Shërbimet për depistimin e kancerit të gjirit**, të ofruara përmes njësive të lëvizshme të mamografisë, do të arrijnë 100 gra më shumë çdo vit në periudhën 2024–2026. Ky zgjerim, me kosto 12,500,000 Lekë Shqiptare, synon të përmirësojë parandalimin e kancerit të gjirit duke rritur mbulimin e depistimit ndër gratë e moshës 50–60 vjeç nga 15.2% në 2023 në 30.3% deri në vitin 2026.

d. Buxheti i shtetit 2024 përfshin një shumë prej 25,000,000 lekë, me **synimin përfitimin nga shërbimet e depistimit të kancerit të qafës së mitrës nga gratë dhe vajzat**, duke i dhënë mundësi depistimi falas rreth 13,000 grave e vajzave për periudhën 2024–2026 kundrejt 11,000 prej tyre në 2021. Ky investim synon gjithashtu uljen e vdekshmërisë nga kanceri i qafës së mitrës nga 2.5/100 000 persona në vitin 2023 në 2.4/100 000 persona në vitin 2026.

e. Me një kosto prej 342,000,000 lekë do të **zhvillohen programe të reja për programet e nxitjes së punësimit** të grave dhe vajzave duke rritur numrin e të punësuarave në 1,520 nga 2,000 që ishte në vitin 2023.

f. **Punësimi pas përfundimit të Formimit Profesional i grave** prej 7,015 nga 11,500 përfitues gjithsej (ose 61%) me një kosto prej 142,600,920 lekë.

g. Krijimi i **mundësive të ndryshme punësimi nëpërmjet arsimit profesional** për 18,000 vajza dhe djem, nga të cilat 2,750 janë vajza (ose 15% ndaj totalit) dhe kostoja për shkollimin parashikohet të jetë 284,084,625 lekë.

h. **Buxheti për programet e mbrojtjes sociale** garanton mbështetjen e mbi 64 mijë familjeve, pjesë e programit të ndihmës ekonomike, ku rreth 45% të përfituesve janë gra të dhunuara.

i. Do të rritet financimi i politikës së rishikimit të masës së përfitimit për Ndihmën Ekonomike, si dhe politika e mbështetjes për çmimin e energjisë për përfituesit e kategorisë së PAK (Pagesa e Aftësisë së Kufizuar), **ku rreth 44% të përfituesve janë gra;**

j. Vijon financimi i **politikës së mbështetjes së veçantë për gratë e papuna me 3 apo më shumë fëmijë deri 18 vjeç**, me të ardhura familjare deri në 100 mijë lekë në muaj, duke i mbështetur me pagesën e kontributeve shoqërore dhe shëndetësore, për periudhën e kujdesit ndaj fëmijës deri 5 vjeç.

k. Për vitin 2024 parashikohet të përfitojnë **8,000 gra krahasuar me 5,580** gra përfituese në vitin 2023, me një kosto prej 800,000,000 lekë;

l. **Mbështetje me pension familjar** për 41 831 gra me një kosto prej 8,726,044,066 lekë, (kontribues+ transfertat nga buxheti).

m. Pagesa për barrë lindje për 14,993 nëna ose baballarë me një vlerë 5 miliard lekë.

n. Vijon financimi i **Programit të "Bonusit të Bebes"** për çdo të porsalindur, duke garantuar shpërblimin financiar nga 40,000-120,000 lekë për mbi 45 mijë fëmijë/vit, si një mënyrë për të ndihmuar sidomos nënat dhe baballarët e rinj, të cilët nuk kanë qenë asnjëherë pjesë e tregut të punës, për të përballuar muajt e parë të lindjes së bebes.

o. Skemat e investimeve për **përmirësimin e kushteve të jetesës për gra dhe burra nga grupet sociale**, parashikohen mesatarisht 295 familjeve përfituese në nevojë, me një kosto prej 295,000,000 lekë.

p. Për gratë dhe vajzat e dhunuara, apo familje një prindërore, do të vijohet mbështetja me **strehim social**. Kostoja për strehimin social të 850 grave dhe vajzave të kategorisë së përcaktuar sipas ligjit do të jetë 47,562,600 lekë, përlllogaritur si përpjesë e dy produkteve kryesore të skemave.

18. Sidoqftë buxheti i vitit **2024 ka mungesë të indikatorëve të performancës** në fusha të rëndësishme sipas shembujve më poshtë:

a. Mbështetja e 60 projekteve me thirrje në mbështetje e industrive krijuese, **duke respektuar barazinë gjinore**, të drejtat e njeriut, grupet e marginalizuara dhe diversitetin kulturor në rang vendi.

b. Edhe gjatë vitit 2024 do të vijojë adresimi i çështjeve që lidhen me barazinë gjinore kryesisht në fushën e arsimit, shëndetësisë, mbrojtjes sociale, drejtësisë dhe rendit publik.

c. Rritjen e numrit të sportistëve të licencuar në federatën shqiptare të sportit, në 34,000 deri në vitin 2026, **në përputhje me parimet e barazisë gjinore**.

d. Buxheti për qytetarët i Vitit 2024 nuk ka të përmendur drejtime kryesore siç i kishte buxheti i vitit 2023. Sidoqftë në buxhetin për qytetarët 2024, Ministria e Financave parashikon rritje të ndjeshme të shpenzimeve për mbështetje sociale ku rreth 238 miliardë leke nga 50 miliardë lekë në 2023 do të akordohen në buxhet vetëm për mbështetjen sociale në vitin 2024.

e. Në buxhetin e vitit 2024 nuk ka asnjë informacion se sa programe buxhetore lidhen me çështjet e barazisë gjinore, ndërkohë që në buxhetin për qytetarët në vitin 2023 kishte **47 (dyzet e shtatë) programe buxhetore** ku do të adresoheshin çështje të barazisë gjinore kryesisht në fushën e arsimit, shëndetësisë, mbrojtjes sociale, drejtësisë dhe rendit publik.

Shqipëria renditet e para në rajon për sa i përket mbështetjes financiare për buxhetimin e përgjigjshëm gjinor, ndaj Qeveria Shqiptare duhet të mbajë të paktën të njëjtën qasje osë të përforcojë atë dhe jo të mënjanojë indikatorë kaq të rëndësishëm siç është numri i programe buxhetore të përgjigjshme nga pikëpamja gjinore.

BPGJ ka filluar në Shqipëri që nga viti 2008, kur Shqipëria prezantoi një ligj të ri organik që e bëri programimin e buxheteve të detyrueshëm dhe shtoi indikatorë të bazuar në performancën e programeve buxhetore afatmesme që fokusoheshin në qëllimet, objektivat dhe rezultatet. Si rezultat, buxhetimi i përgjigjshëm gjinor (BPGJ) filloi të zbatohet në programe në vitin 2016. Përfshirja e shoqërisë civile është thelbësore, në edukimin dhe udhëzimin e ministrive që të përfshijnë dhe të shpërndajnë të dhëna të ndara sipas gjinisë, si pjesë e përpjekjes për të advokuar për çështjet e barazisë gjinore.

Si përfundim, **buxheti 2024 ka perspektivë gjinore, sidoqftë mungesa e analizave gjinore shoqëruese apo shqyrtimi post legjislativ** i zbatimit të ligjeve apo strategjive nuk ndihmon në alokimin e duhur të fondeve të cilat do të shërbejnë nevojave praktike dhe strategjike të gjinive të ndryshme. Është thelbësore që investime të parashikuara në buxhetin e shtetit të udhëhiqen nga kërkime dhe analiza të plota për t'u siguruar që ato të japin rezultatet më të mira ndak grupeve të targetuara e sidomos shtresave të marginalizuara. Gjithashtu buxheti i shtetit duhet të shoqërohet me një analizë gjinore të buxhetit të mëparshëm.

Rekomandime 2024

Analiza e buxhetit të përgjigjshëm gjinor

Duhet të kryhet një analizë të thellë gjinore të realizimit të buxhetit të vitit 2023 për të identifikuar zonat ku ekzistojnë dallimet gjinore dhe për të kuptuar ndikimin diferencial të politikave buxhetore sipas gjinisë. Kjo analizë duhet të shqyrtojë modelet e shpenzimeve, burimet e të ardhurave dhe politikat ekonomike.

Konsideratat kryesore gjinore

Duhet të integrohet konsideratat gjinore në të gjitha fazat e procesit buxhetor, duke përfshirë planifikimin, formulimin, zbatimin dhe vlerësimin. Kjo përfshin vendosjen e mekanizmave për të vlerësuar sistematikisht implikimet gjinore të vendimeve buxhetore në të gjitha sektorët.

Alokoni burime për të adresuar boshllëqet gjinore

Duhet alokuar burime të mjaftueshme për të adresuar boshllëqet specifike gjinore në fusha si arsimi, kujdesi shëndetësor, punësimi dhe mbrojtja sociale. Kjo mund të përfshijë rritjen e financimit për programet që promovojnë fuqizimin ekonomik të grave, adresojnë dhunën me bazë gjinore dhe përmirësojnë qasjen në shërbime të rëndësishme për grupet e marginalizuara.

Investoni në mbledhjen e të dhënave dhe hulumtimin

Duhet përmirësuar përpjekjet për të mbuluar të dhëna sipas gjinisë që të mund të ndiqni progresin drejt barazisë gjinore. Kjo mund të përfshijë mbledhjen e të dhënave të ndara sipas gjinisë në dokumentet buxhetore dhe realizimin e vlerësimeve të ndikimit gjinor të politikave buxhetore.

Promovoni fuqizimin ekonomik të grave

Duhet zbatuar politika dhe programe që synojnë të promovojnë fuqizimin ekonomik të grave, duke përfshirë qasjen në financime, zhvillimin e aftësive, mbështetjen e sipërmarrjes dhe promovimin e pjesëmarrjes së grave në proceset e vendimmarrjes të lidhura me çështjet buxhetore.

Mbështetje për punën e kujdesit të papaguar

Duhet njohur dhe vlerësuar puna e kujdesit të papaguar, kryesisht të kryer nga gratë, duke zbatuar politika të tilla si leja prindërore, rregullime fleksibël të punës dhe investime në shërbimet e kujdesit për fëmijët për të mundësuar një pjesëmarrje më të madhe të grave në fuqinë punëtore dhe për të zvogëluar barrën e punë përkujdesjeje pa pagesë.



Rekomandime 2024

Trajtimi i dhunës me bazë gjinore

Duhet alokuar burime adekuate dhe të plota që Strategjia Kombëtare e Barazisë Gjinore të plotësojë misionin e saj për të parandaluar dhe për t'iu përgjigjur dhunës me bazë gjinore, duke përfshirë financimin për shërbimet mbështetëse, ndihmën ligjore dhe fushata ndërgjegjësuese që synojnë ndryshimin e qëndrimeve dhe normave shoqërore që përjetësojnë dhunën ndaj grave dhe gjinive të tjera.

Politikat bujqësore të përgjigjshme ndaj gjinisë

Duhet siguruar që politikat bujqësore të marrin parasysh nevojat dhe kontributet specifike të grave fermere, të tilla si aksesimi në tokë, kreditë dhe shërbimet e ekstensionit bujqësor, për të rritur produktivitetin e tyre dhe për të promovuar sigurinë ushqimore dhe zhvillimin rural.

Forconi kapacitetet institucionale

Duhet ndërtuar kapacitetet e punonjësve për të integruar çështjet gjinore në politikat dhe programet e tyre, mund të realizohet përmes trajnimeve mbi buxhetimin e përgjigjshëm gjinor dhe krijimin e një zyre të veçantë që merret me mbledhjen e të dhënave dhe monitorimin e zbatimit të parimeve të buxhetimit të përgjigjshëm gjinor.

Angazhoni shoqërinë civile dhe palët e interesuara

Duhet nxitur partneritete me organizatat e shoqërisë civile, grupet e grave dhe palët e tjera të interesuara për të siguruar pjesëmarrjen e tyre kuptimplotë në procesin buxhetor dhe për të shfrytëzuar ekspertizën e tyre dhe përpjekjet e avokimit për të avancuar qëllimet e barazisë gjinore.

Monitoroni dhe vlerësoni progresin

Duhet të krijohen mekanizma për të monitoruar dhe vlerësuar ndikimin e nismave buxhetore të përgjigjshme ndaj gjinisë, duke përfshirë vendosjen e objektivave dhe treguesve për të gjurmuar progresin drejt rezultateve të barazisë gjinore dhe duke bërë rregullime të politikave buxhetore sipas nevojës.

Me zbatimin e këtyre rekomandimeve, Ministria e Financave mund të bëjë hapa të rëndësishëm drejt krijimit të një buxheti shtetëror më të orientuar nga gjinia, i cili avancoon barazinë gjinore dhe përfshirjen sociale.



Për më shumë informacione ju lutem kontaktoni:

Mirela Arqimandriti

Drejtoreshë Ekzekutive

Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim

E-mail: marqimandriti@gadc.org.al

